



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	16.04.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDR/SHK	1841/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 217/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2278/2019, të datës 15.03.2021 shqyrtuan ankesën, A.nr.396/2019, të datës 15.07.2019, së ankuesit ne adresë fshati Smirë, në Komunën e Vitisë, kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.396/2019, e datës 15.07.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET NË FUQI. Vendimi Nr. 02-320/04-25922, i datës 17.06.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Vitisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vitisë, me datën 11.04.2019, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën „ Sekretar i Shkollës Fillore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë “, në Komunën e Vitisë, nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Shërbimin Civil.

Komuna e Vitisë, me datë 12.04.2019, ka shpallur konkursin për pozitën „ Sekretar i Shkollës Fillore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë “, në Komunën e Vitisë.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 13.05.2019, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit për pozitën „ Sekretar i Shkollës Fillore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë “, me datë.

30.05.2019, me numër protokoll 02-320/04-25922 me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Vitisë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Vitisë, me datë 17.06.2019, me numër protokoll Nr. 02-320/04-25922, ka nxjerr vendim me të cilën ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në Ligj.

Ankuesi pakënaqur me vendimin me nr. protokoll 02-320/04-25922, datës 17.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Komunës së Vitisë, brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.07.2019, për mes postës së Kosovës, ka paraqitur ankesë e cila ankesë është pranuar me datën 15.07.2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit për pozitën 'Sekretar i Shkollës Fillore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë ”, në Komunën e Vitisë, është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Komuna e Vitisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.07.2019, me numër protokoll 3308/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa me datën 06.08.2019 me numër protokoll 3433/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Vitisë, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 03.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.03.2021, me numër A.nr. 2278/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditës të vendos lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 396/2019, me numër protokoll 3134/2019 e datës 15.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën A.nr. 217/2021, e datës 01.04.2021, sipas Aktgjykimit A.nr. 2278/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi A.nr. 264/2013 e datës 08.02.2016, e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktgjykimi A.nr. 367/2018 e datës 08.02.2016, i Gjykatës e Apelit e Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 729/16 e datës 04.05.2018, e Gjykatës

Themelore në Prishtinë; Vendimi i datës 01.04.2016, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 30.05.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 17.06.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimi i datës 13.05.2019; kërkesa për miratim e datës 10.05.2019; Renditja përfundimtare e kandidateve; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Rekomandim nga Komisioni për zgjedhës; Konkurs i datës 12.04.2019; Autorizimi i datës 11.04.2019, i Ministrisë së Administratës Publike; lista e ngushtë; Vendimi i datës 02.05.2019, për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 26.02.2013; Vendimi i datës 08.10.2013; Dëshmi nga Trusti; Përgjigje në Ankesë e datës 06.08.2019, me numër protokoll 3433/2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave fillimisht ka analizuar Aktgjykimin, me numër A.nr. 2278/2019, të datë 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin Aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh Këshilli të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 15.07.2019, të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 12.04.2019, nga Komuna e Vitisë, për pozitën „ Sekretar i Shkollës Filllore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë”, në Komunën e Vitisë kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare; ne Juridik ose Administratës Publike*
- *përvoja e punës (2) vite Profesionale*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil të Kosovës i Komunës së Vitisë, ka vepruar në pajtim me nenin 34, paragrafi 4 të Rregullores 02/2010, për procedurat e rekrutimit në shërbimin Civil ku thuhet se; Pas përfundimit të testimeve me shkrim dhe me gojë kryesuesi përgatit për menaxherin e personelit një raport të shkurtër me shkrim në të cilin përcakton vendin kur janë mbajtur testimet emrat e anëtareve të komisionit emrat e kandidateve të rekomanduar, të cilët janë nënshtruar testimit, prandaj në rastin konkret Kryesuesi i Komisionit përzgjedhës i Shërbimit civil me datën 10.05.2019, për mes shkresës Zyrtare ka njoftuar Menaxherin e Personelit në Komunën e Vitisë, mbi rrjedhën e procesit të rekrutimit për pozitën “Sekretar i Shkollës Filllore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë”, me të cilin është konstatuar se Ankuesi është tërhequr nga testimi me shkrim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në lidhje në konkursin e shpallur të datës 12.04.2019, nga Komuna e Vitisë, për pozitën „ Sekretar i Shkollës Filllore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë” si dhe përzgjedhjen e kandidatit sepse në rastrin konkret Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Ankuesi nuk i është nënshtruar testimit me shkrim për pozitën „ Sekretar i Shkollës Filllore „ Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë”, dhe një gjë të tillë e ka konstatuar edhe në



ankesën e parashtruar tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se nuk i është nënshtruar testimit me shkrim.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit nga Komuna e Vitisë, është bërë në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Vitisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. Nr. 02-320/04-25922 ,, të datës 17.06.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankuesit Isuf Sylejmani, për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Sekretar i Shkollës Filllore ,, Dëshmoret e 5 Prillit - Smirë", të zhvilluara nga Komuna e Vitisë.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr. 217/2021, datë 16/04/2021*

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

